



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 39/2023

Drejtuar:

Z. Petrit Reçica, Kryeshef ekzekutiv
Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.

Për njoftim:

Z. Përparim Rama, Kryetar
Komuna e Prishtinës

Prishtinë, më 18 mars 2025

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Kompanisë Regjionale të Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” Sh.A. lidhur me obligimin ligjor për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në kërkesën e _____, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të _____ (në tekstin e mëtejshëm: ankuesi) dhe mbështetet në faktet dhe në provat e ankuesit si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Avokati i Popullit, lidhur çështjen e ngritur në IAP nga ankuesi.

Baza ligjore

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*”, ndërsa në nenin 135, paragrafi 3 përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjerash, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “*Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
 - *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).”*

Përmbledhje e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 23 janar 2023 pranoi ankesën e _____ parashtruar kundër Kompanisë Regjionale të Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” Sh.A., për mospërgjigje në kërkesat e tij.
6. Sipas dokumentacionit dhe informatave që ankuesi ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), _____ më 29 korrik 2022, iu drejtua me kërkesë KRM-së “Pastrimi” Sh.A., me numër reference 2863, lidhur me kompensimin për orët e punëve shtesë, të kryera gjatë ditëve të festave, gjatë vikendit si dhe për orët e punëve gjatë orarit të natës. Ankuesi pohoi se më 10 janar 2023 e përsëriti kërkesën, por nuk mori përgjigje.
7. Më 6 prill 2023, Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë ushtrueses së detyrës së kryeshefes ekzekutive të KRM-së “Pastrimi”, nëpërmjet së cilës kërkoi informata për veprimet që ishin

ndërmarrë dhe për ato që planifikoheshin të ndërmerreshin nga KRM “Pastrimi”, Sh.A., përkitazi me kërkesën e ankuesit.

8. Më 31 korrik 2023 ankuesi njoftoi se parashtrroi ankesë në Inspektoratin e Punës.
9. Më 7 gusht 2023, Avokati i Popullit iu drejtua kryeshefit ekzekutiv të KRM-së “Pastrimi”, me shkresë rikujtuese.
10. Më 19 shtator 2023, ankuesi solli informata shtesë, respektivisht njoftoi se Inspektorati i Punës nxori vendim lidhur me rastin e ankuesit, me të cilin i shqiptoi masë ndëshkimore KRM-së “Pastrimi”, për shkak të mospërgjigjes në kërkesat e tij lidhur me lëndën.
11. Më 13 dhjetor 2023, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryeshefi ekzekutiv i KRM-së “Pastrimi”, nëpërmjet së cilës njoftoi se për shkak të ndryshimeve në strukturën dhe riorganizimin e stafit, shqyrtimi dhe marrja e vendimit ndaj kërkesave të ankuesit nuk u bë. Për më tepër, ai njoftoi si vijon: *“Meqenëse tashmë nuk ekzistojnë pengesa të tilla, ju vëmë në dijeni se jemi duke shqyrtuar kërkesat e dhe ndaj të njëjtave, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, do të merret vendim konkret për të cilin e ju si IAP do të njoftoheni me shkrim për vendimin përkatës.”*
12. Më 10 maj 2024 dhe më 8 korrik 2024, përfaqësuesja e IAP-së u njoftua nga ankuesi se deri në këtë datë KRM “Pastrimi” ende nuk ndërmori asnjë veprim për trajtim dhe vendosje në kërkesën e
13. Më 25 korrik 2024, Avokati i Popullit iu drejtuar përsëri me shkresë kryeshefit ekzekutiv të KRM-së “Pastrimi”, nëpërmjet së cilës kërkoi informata nëse kjo e fundit i ka ndërmarrë veprimet përkitazi me kërkesën e , ashtu siç ka pohuar në përgjigjen e datës 13 dhjetor 2023 drejtuar Avokatit të Popullit.
14. Avokati i Popullit nuk mori përgjigje në këtë shkresë.
15. Lidhur me veprimet e IAP-së u njoftua ankuesi.

Baza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]:

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve [...].”

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]:

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative:

Kapitujt: “Kërkesa dhe parashtrimi i saj”; “Fillimi i procedurës administrative”; “Parimet e shqyrtimit administrativ”; “Përfundimi i procedurës administrative”; “Parimi i përfundimit të procedurës administrative”; “Afat”.

Ligji nr. 03/L-212 i Punës:

Neni 56 [Paga shtesë]”

“1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.[...]”

Analiza ligjore

16. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit përkitazi rastin e Ankesës nr. 39/2023 bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e zbatueshme në vend. Avokati i Popullit në këtë raport analizon zbatimin e detyrimeve ligjore nga autoriteti përgjegjës përkitazi me garancitë detyruese ligjore për zhvillimin e procedurës administrative në pajtim me ligjin.
17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton: “Të drejtat e dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.” Sipas Kushtetutës: “Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.” [Neni 21].
18. Trajtimi i kërkesave në administratën publike të Republikës së Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Me këtë ligj përcaktohen standardet, procedurat dhe afatet për trajtimin e kërkesave.
19. Forma, përmbajtja, parashtrimi i kërkesës, regjistrimi dhe vërtetimi i parashtrimit së kërkesës është i rregulluar qartësisht me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenet 73, 74 dhe 76.
20. Procedura administrative fillon sipas kërkesës së palës [...]¹. Në rastin konkret, ankuesi filloi procedurën më 29 korrik 2022, me ç’ rast iu drejtua KRM-së “Pastrimi” Sh.A. me Kërkesën nr. 2863. Kërkesa ka të bëjë me kompensimin e orëve për punë shtesë gjatë ditëve të festave, gjatë vikendit si dhe për orët e punëve gjatë orarit të natës. Ankuesi pohoi se më 10 janar 2023 e përsëriti kërkesën, por nuk mori përgjigje.
21. Shqyrtimi i një procedure të filluar administrative është obligim ligjor dhe detyrim për organin publik, të cilit i është drejtuar kërkesa. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 86, paragrafi 1, shprehimisht përcakton: “Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.” Ndërsa në paragrafin 2 përcakton: “Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.”
22. Për zgjidhjen e çështjes përkatëse, ligji i ka vendosur edhe detyrimet e palës për të

¹ Neni 83, paragrafi 1, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

bashkëpunuar me organin publik, përkatësisht në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme (neni 87 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

23. Përfundimi i procedurës administrative realizohet me njoftim nëpërmjet një akti administrativ drejtuar palës kërkuese. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 97, paragrafi 1, përcakton: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative.”*
24. Afati për përfundimin e procedurës administrative është 45 ditë nga fillimi i saj, ose sa më shpejt të jetë i mundur, por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në nenin 98, paragrafi 1, shprehimisht përcakton: *“Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.”* Ndërsa në paragrafin 2 përcakton: *“Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.”*
25. Bazuar në garancitë ligjore të specifikuara më lart lidhur me fillimin, shqyrtimin dhe përfundimin e një procedure administrative dhe po ashtu bazuar në rrethanat dhe dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi si dhe veprimet e ndërmarra nga IAP-ja gjatë hetimit të rastit, autoriteti përgjegjës KRM “Pastrimi” Sh.A. nuk ka vepruar në përputhje me ligjin për shqyrtimin dhe përfundimin e një procedure administrative sipas kërkesës së iniciuar nga ankuesi . Ankuesi në kërkesën e tij nuk ka marrë asnjë akt administrativ për epilogun e kërkesës së tij, nëpërmjet së cilës ai ka kërkuar kompensimin për orët e punëve shtesë, të kryera gjatë ditëve të festave, gjatë vikendit si dhe për orët e punëve gjatë orarit të natës. Kërkesa e ankuesit është legjitime dhe e bazuar në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës (neni 56 - Paga shtesë) dhe në kontratën e punës së ankuesit me KRM-në “Pastrimi” Sh.A.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

26. Avokati i Popullit, bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë raport, konstaton se në këtë rast KRM “Pastrimi” Sh.A. ka dështuar ta përmbushte obligimin ligjor për shqyrtim dhe vendosje për kërkesën e ankuesit. Mungesa e nxjerrjes së një akti administrativ të bazuar në fillimin e një procedure administrative sipas kërkesës së palës krijon përveçse pasiguri juridike, në rrethanat e rastit konkret krijon pasiguri në plotësimin e kushteve dhe të të drejtave nga marrëdhënia e punës, shkelje të së drejtës në procedurë dhe krijimin e vështirësive për shfrytëzimin e mjeteve juridike.
27. Avokati i Popullit konstaton se trajtimi, shqyrtimi dhe vendosja për kërkesë është obligim ligjor për autoritetin publik dhe në anën tjetër është e drejtë e çdo individit për trajtimin e kërkesës së tij/saj në përputhje me ligjin, nëpërmjet një procedure të rregullt ligjore dhe për marrjen e një përgjigje apo vendimi të bazuar në të drejtën e palës, të përcaktuar me ligj, si për procedurën e ndjekur, ashtu edhe për të drejtën në substancë.


Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*), në cilësinë e rekomanduesit, i

REKOMANDON

Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.:

- *T’i ndërmarrë veprimet procedurale për ta shqyrtuar dhe vendosur për kërkesën e , në pajtim me të drejtat ligjore nga marrëdhënia e punës, pa vonesa të mëtutjeshme.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete. [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit